

VENDIM
Nr. 1080, datë 18.12.2013

PËR KRIJIMIN DHE PËRBËRJEN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 8 të ligjit nr. 111/2012, datë 15.12.2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave
VENDOSI:

1. Krijimin e Këshillit Kombëtar të Ujit, si organi qendror vendimmarrës në fushën e administrimit të burimeve ujore të Republikës së Shqipërisë.

2. Këshilli Kombëtar i Ujit kryesohet nga Kryeministri dhe ka në përbërje:

- Zëvendëskryeministrin anëtar;
- Ministrin e Mjedisit anëtar;
- Ministrin e Bujqësisë, Zhvillimit Rural
dhe Administrimit të Ujërave anëtar;
- Ministrin e Energjisë dhe
Industrië anëtar;
- Ministrin e Zhvillimit Ekonomik,
Tregtisë dhe Sipërmarrjes anëtar;
- Ministrin e Transportit dhe
Infrastrukturës anëtar;
- Ministrin e Zhvillimit Urban
dhe Turizmit anëtar;
- Ministrin e Punëve të Brendshme anëtar;
- Ministrin e Financave anëtar;
- Ministrin e Shëndetësisë anëtar.

3. Në mbledhjet e Këshillit Kombëtar të Ujit ftohen të marrin pjesë përfaqësues të Entit Rregullator të Ujit, të pushtetit vendor dhe të shoqërive të shërbimit, konsumatorëve, biznesit, shoqërisë civile, si dhe aktorë e ekspertë të fushës.

4. Vendimi nr. 775, datë 28.10.1996, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Këshillit Kombëtar të Ujit”, i ndryshuar, shfuqizohet.

5. Ngarkohen anëtarët e Këshillit Kombëtar të Ujit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama